## Titulli i lëndës: DISKURSET NË ARKITEKTURË

| Informatat themelore për lëndën | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i Arkitekturës |
| **Titulli i lëndës:** | Diskurset në Arkitekturë |
| **Niveli:** | MScA |
| **Statusi i lëndës:** | Zgjedhore |
| **Viti i studimeve:** | I |
| **Numri i orëve në javë:** | 2+0 |
| **Kreditë ECTS:** | 3 |
| **Koha / Vendi:** | sipas orarit |
| **Mësimdhënësi:** | Prof.Ass.Dr. Kaltrina Thaçi |
| **Të dhënat kontaktuese:** | kaltrina.thaci@uni-pr.edu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Lënda shtjellon temat kryesore të arkitekturës si tektonika, përdorimi dhe vendi, të cilat mbeten qendrore për disiplinën mbi dymijëvjecare të arkitekturës. Zhvillimi i hovshëm sot sjell vijueshëm materiale dhe teknologji të reja, e gjithashtu sfidat mjedisore dhe sociale janë gjithnjë në rritje. Kjo bën që aktualiteti i të përditshmes të përcaktohet si kohë jetike për të studiuar diskurset në arkitekturë. Lënda informon studentët mbi fenomenet, nocionet dhe diskutimet në disiplinën e arkitekturës në formë të një bisede trilogjike midis teksteve diskursive si tezë (teksti burimor), antitezë (teksti reflektiv) dhe sintezë (teksti filozofik). Tekstet burimore, të cilat janë qendrore për të kuptuar diapazonin e debatit në arkitekturë janë shkruar nga arkitektë dhe kritikë e filozofë të arkitekrës, dhe jo rrallë janë manifestuar si vepër arkitektonike në formë të manifestit arkitektural. |
| **Qëllimet e lëndës:** | Qëllimi i lëndës është që sudentët të mësohen të ambientojnë rolin e tyre kundrejt sfidave dhe mundësive të reja të disiplinës. Duke qenë se debati përqendrohet në mënyrën se si struktura, hapësira, forma, materiali, programi dhe konteksti janë transformuar për të adresuar këto çështje, studentët bëhen pjesë aktive në këtë transformim, duke u mësuar që të zhvillojnë konceptin arkitektonik të gjeneruar nga një pozitë teorike. |
| **Rezultatet e pritshme të nxënies:** | Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të:<br>– zhvillojnë dhe përmirësojnë kulturën e debatit dhe aftësinë e njohjes së dialektikës në arkitekturë |

| | |
|---|---|
| | – krijojnë një kornizë kritike të gjykimit për idenë, konceptet themelore dhe prodhimin arkitektonik në kontekst, rrjedhimisht të bëhen pjesë e diskursit arkitektural;<br>– zhvilliojnë aftësitë për të argumentuar dhe paraqitur në një mënyrë të strukturuar propozimet, idetë dhe projektet e tyre të gjeneruara nga qasja diskursive. |

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Teori/Punë në laborator/Ushtrime | 1 | 3 | 3 |
| Punë praktike | | | |
| Përgatitje për test intermediar | 2 | 4 | 8 |
| Konsultime me mësimdhënësin | 0.5 | 12 | 6 |
| Puna në terren | | | |
| Testi, punimi seminarik | | | |
| Detyrë shtëpie | 1 | 12 | 12 |
| Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi) | 1 | 10 | 10 |
| Përgatitja për provimin final | 2 | 2 | 4 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final) | | | 2 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 5 | 5 |
| Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë... | | | |
| **Total** | | | **75** |

| | |
|---|---|
| **Metodat e mësimdhënies:** | Ligjeratë e avansuar dhe diskutime, detyrë shtëpie grupore dhe individuale. |
| **Metodat e vlerësimit:** | *Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%. Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat seminarike dhe prezantimet e studentëve 30%, Vlerësimi nga panel diskutimet 20% ose Provimi final 40%* |

| | |
|---|---|
| **Literatura primare:** | C.G. Crysler (2003). Writing Spaces. Discourses of Architecture, Urbanism, and the Built Environment 1960-2000, Routledge<br>K. Smith (2012). Introducing Architectural Theory: Debating A discipline, Routledge, New York, NY<br>E. Ots, (2010) Decoding Theoryspeak, Routledge, New York, NY<br>Hanno - Walter Kruft (1996) History of Architectural Theory, from Vitruvius to the present, 1 edition, Princeton Architectural Press |

| | |
|---|---|
| **Literatura shtesë:** | F.Jerliu (2005) Dispencë: Teoria dhe Kriticizmi në Arkitekturë, UP/WUS<br>Hilde Heynen (2000) Architecture and modernity, A Critique, The MIT Press; Revised edition<br>Ch. Jencs , K.Kropf (2006)Theories and manifestoes of contemporary architecture, second edition, Academy Press<br>H. Pai, H. Pae (2002). The Portfolio and the Diagram: Architecture, Discourse, and Modernity in America, MIT Press |

| **Hartimi i planit mësimor** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Titulli i ligjëratës** | **Ushtrimet** |
| ***Java 1:*** | Çka do të thotë Diskursi i arkitekturës? | Udhëzues mbi literaturën |
| ***Java 2:*** | Arkitektura: nevojë apo edhe më shumë? | Caktimi i detyrave seminarike |
| ***Java 3***: | Arkitektura si diskurs kulturor dhe politik:  Kultura, Politika | Hyrje në analizë, diskurset dhe te menduarit/shkruarit kritik |
| ***Java 4:*** | Arkitektura si diskurs shoqëror: “izmat” dhe e drejta në qytet (seksizmi, racizmi, moshizmi, etj) | Analiza komparative |
| ***Java 5:*** | Dy Qytete: Infrastruktura dhe Jeta | Diskutim |
| ***Java 6***: | Territorialiteti dhe përkatësia | Diskutim |
| ***Java 7:*** | Arkitektura e të 'padefinuarëve': Zona gri (grayzones), Refugjatët / individi pa shtetësi | |
| ***Java 8:*** | Vlerësimi preliminar (testi 1) | Vlerësimi intermediar (prezantim / dorëzimi i draftit) |
| ***Java 9:*** | Arkitektura dhe qyteti në Neo-liberalizëm | Analizë: teoria, diskursi apo filozofia- teza |
| ***Java 10:*** | Arkitektura si shkaktar/zgjidhje për ndryshimet klimatike | Përpilimi dhe strukturimi i argumenteve të tezës |
| ***Java 11***: | Arkitektura dhe Etika | Analizë: teoria, diskursi apo filozofia - antiteza |
| ***Java 12***: | “Urbaniti Kompetent” | Përpilimi dhe strukturimi i argumenteve të antitezës |
| ***Java 13***: | Arkitektura e mbyllur dhe e hapur | Analizë: Aplikimi i paimeve të tezës dhe antietzës në kontekstin lokal - sinteza |
| ***Java 14***: | Homo Faber / Homo Deus Arkitektura, planifikimi dhe etika në epokën e intelegjencës artificiale | Përpunimi i mëtutjeshëm i sintezës |
| ***Java 15***: | Vlerësimi përfundimtar (testi 2) | Dorëzimi i detyrës seminarike |

| Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes |
| --- |
| Ligjëratat dhe prezenca në diskutime paneli janë obligative; ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë; inkurajohet shfrytëzimi i teknologjisë së mençur për diskutim/prezantim, ndërsa nuk lejohen përdorimi i tyre për aktivitete tjera si kontrollimi i e-mailit personal apo rrjeteve sociale. |

**Shënim | Nëse studenti vlerësohet nën 50% në panel diskutime dhe prezantim, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final.**